



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 42-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 29.04. 2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Fitim Shala, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
17. Shkelzen Bislimi, anëtar
18. Albulena Kelmendi, anëtare
19. Alban Salihu, anëtar
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Fehmi Rexhepi, anëtar
29. Arben Salihu, anëtar

30. Argjend Tasholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Merita Bytyqi, DSH
5. Anila Reçica, DKRS
6. Nazim Gashi, DE
7. Emina Rexhiq, DPU
8. Elmaze Behluli, DKA
9. Shefqet Amerllahi, DB
10. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj që të kemi një vit të mbarë dhe të keni shëndet dhe suksese ju dhe familjet tuaja.

Po ashtu tha se të infektuarve me Covid-19 ju uroj shërim të shpejtë ndërsa atyre që kanë humbur familjarët e tyre ju shprehu ngushëllime.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit; Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 41-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2021.
3. Propozim vendim për aprovimin e rezervës komunale 2021-2023.
4. Propozim vendim për lirim nga pagesa e qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
5. Propozim rregullore për taksat komunale.
6. Propozim vendim për fillimin e procedurave për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" sh.a.
7. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Emina Rexhiq,tha se kam një propozim që të jetë një pikë shtesë propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarët e kombit pasi që na është kthye nga ministria prapë me arsyetimin se duhet të përfshihen edhe dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe dokumente tjera të planifikimit Hapësinor.

Lulzim Rrustemi,është bërë si normë që çdo seancë po shtohen ka 2-3 pika dhe është një normë jo e mirë, pasi që paraprakisht ne duhet me pas materialin më herët,ne s'jemi kundër pikave por duhet një përgatitje për ato pika.

Daut Azemi,është një plotësim i një vendimi dhe nuk mendoj qe donë debat shumë kjo pikë,ministria ka kërkuar që të bëhen disa ndryshime dhe na për ta nxanë afatin ligjor e kemi prurë në seancë. Dhe kuvendi është ai që vendos se do ta fus në rend të ditës ose jo.

Meqë vërejtje tjera as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pastaj u vazhdua me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Shkelzen Bislimi,kam një pyetje për drejtorin e prokurimit rreth kontratës për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit verorë. Kontratë e lidhur me kompaninë Gashi MG,ku kompania ne fjalë obligohet për largimin e kafshëve nga hapësirat publike me një çmim prej 1100 euro për copë. Kjo po i bjen qe nëse një mace ngordhë ceremonia e varrimit do t'i kushtoj 1100 euro. Deshta me pyet drejtorin pse ky çmim kaq i lartë për këtë shërbim. E përsëritet fillimin e punimeve të shtigjeve të ecjes në fshatin Gadime,por njëjtë duhet vazhduar edhe me zonën turistike Plitkoviqi

Lulzim Rrustemi,unë i kam nja 3 pyetje dhe një kërkesë,e para rruga „Hajredin Bajrami” dhe „Shqipëria” sipas cilit projekt është duke u punu dhe cila është koha qe duhet me përfundu. E dyta,në mbledhjen e kaluar e kemi aprovu një projekt për lumin Janjevka në cilën pjesë të lumit Janjevka do të ndërtohen muret. Rruga në lagjen Akllapit që është duket u ndërtuar rreth autostradës me çfarë projekti është duke u ndërtuar. Dhe kam një kërkesë të dy mbesave të Stjefan Gjeqovit ku kanë kërku që të bëhet një përkujdesje për shtëpinë e tyre e cila është në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Kërkojnë ndihmë për banim nëse ka mundësi pasi që e meritojnë me pas banim.

Ramiz Qeriqi,ka një kërkesë të qytetarëve që të ketë edhe një mjek në emergjencë, pasi që aty me datën 30 ka qenë vetëm një mjek dhe kur një qytetar e ka thirrë ne telefon ka thanë se nuk kam mundësi me ardh pasi që jam i vetëm. Po ashtu është kërkesë e qytetarëve me pas kujdestari në QKMF në Shalë. Kesh një ditë në Dobrajë e vizitova stadiumin e Dobrajës, shumë mirë aty që po derdhen mjete por a e keni pa çfarë pune katastrofë është duke u bërë aty, a keni marrë masa ndaj asaj kompanije.Ju kisha lut që të merrni masa ndaj asaj kompanie.

Imri Ahmeti,te kontratat kornizë me ligj nxirret çmimi i mesatares së

kontraktuar dhe jo çmimi që ju e shihni.Nëse gjeni veç një faturë që është paguar ajo

shume që e përmendi asamblesiti unë jap dorëheqje prej pozitës ku jam. Shtegu i ecjes pajtona që të jetë edhe në Plitkoviq dhe në Honrovc dhe është mirë me mendu në periudhat më afatgjate. Projekti i rrugës 4 kursi projekt me shumë telashe ku ne projekt ka pas pozicione të vështira të cilat është kanë e vështirë m'i gjetë ku janë disa gypa të ujësjellësit të cilët janë vështirë m'i gjete as në Kosovë as në Ballkan. Projekti që po implementohet është 3 kursi për shkak se nuk do të mund të hyjmë në shpronësim. Përkujdesja për familjen e Stjefan Gjeqovin ka nevojë por ka nevojë edhe për shume familje për përkujdesje. Pajtohem me Luanin që ka nevojë me shtuar kapacitetet ne shëndetësi por ne po kemi telashe me mjekët të cilët po i lëshojnë vendet e punës për shkak të specializimit por jemi duke diskutuar me mistrinë e shëndetësisë që mjekëve të ju njihet specializimi në QKM apo AMF.

Ganimete Qeriqi,pasi u diskutua për emergjencën unë dola me dhanë një sqarim pasi që edhe punoj aty,të gjithë duhet me ditë se rastet kronike në emergjencë nuk shkojnë dhe po shihet që po manipulohet me emergjencën. Emergjenca nuk është për raste kronike po për aksidente për infarkte për raste të rënda dhe nuk është mirë që të manipulohet me emergjencë.Para disa dite kemi pas një rast me sëmundje kronike që na ka thirrë jemi shkuar dhe na ka blloku veturën për 3 orë pasi që Prishtina nuk na ka pranuar si rast.

Ramiz Qeriqi,pyetjen për stadiumin e Dobrajes që e bona më herët kryetar harruat të më përgjigjeni,faleminderit Ganimete për sqarimin për emergjencë që e bone unë nuk e dita që je bo drejtoreshë,unë vetëm kërkoja që në kohën e pandemisë të jenë dy mjek në emergjencë për shkak se është kërkesë e qytetarëve.

Daut Azemi, për derisa Ganja punon në emergjencë ka të drejtë me dhanë sqarime.

Bashkim Budakova,së pari besimtarëve islam ju uroj muajin shenjtë të Ramazanit. Pyetja ime ka të bëjë me shqetësimin e banorëve të fshatrave Rubofc dhe Kojskë.Siç e dini ju është duke u punuar në rehabilitimin e hekurudhave të Kosovës ku gjatë punimit janë shkaktuar dëme të konsiderueshme të cilat i frekuentojnë banorët e këtyre fshatrave për çdo ditë dhe ato janë rruga nga udhëkryqi i rrugëve nga Rubofc dhe Gllogovc e emërtuar si rruga,, Lipjani" me gjatësi 3500 m,rruga „Murat Zaskoku" me gjatësi 1100 m,rruga „Naim Budakova" me gjatësi 220 m ne fshatin Rubofc dhe rruga „Avdyl Frashëri" me gjatësi 150m në fshatin Kojskë. Ne si komunitet jemi të shqetësuar për dëmtimet dhe pasojat që janë shkaktuar në këto rrugë ku kemi participuar edhe vet me mjete financiare në kohën e ndërtimit të këtyre rrugëve në vitin 2005. Pyetja për ekzekutivin është a kemi ndonjë raport për gjendjen e këtyre rrugëve dhe dëmet që janë shkaktuar në këto rrugë dhe a kemi ndonjë marrëveshje eventuale me punëkryesin se cila do të jetë gjendja e këtyre rrugëve kur dihet që dëmet e shkaktuara nga pesha e madhe e mjeteve të punës është e madhe. Nëse ka ndonjë marrëveshje cila është ajo marrëveshje, Nëse nuk ka ne si komunitet detyrohemi të ndërmarrim masa.

Imri Ahmeti, rruga për Rubofc me të drejtë dhe është problem specifik dhe jo vetëm në rrugën për Rubofc dhe Kojskë por edhe në Lipjan, ne e kemi stopuar punën një kohë dhe nuk i kemi lëshu leje si Komunë sepse kemi dashtë që me detyruar kompaninë ose hekurudhën që me lidhë marrëveshje që dëmet që janë shkaktuar të sanohen dhe kemi dashtë të kemi një garancion. Lejen e ka marr drejtëpëdrejt nga ministria pa na pyetur neve fare. Kemi me dhjetra raporte të inspektorëve, dhe ata po deklarohen që dëmet e shkaktuara do t'i riparojnë dhe pse nuk besojmë që do ti riparojnë. Dhe në fund ne duhet me kërkuar ose nga mistria ose Infrakosi ose punë kryesi që të riparohen dëmet ose komuna do t'i kryej vetë. Jemi në një momentum jo të lehtë të zgjidhjes së kësaj suate. Ne kemi fituar një projekt me riasfaltu rrugën prej Kishes deri te hekurudha po për shkak të punimeve nuk po mujm me filluar me punuar se prishet rruga. Sa i përket stadiumit të Dobrajës nuk e di që është dikush me i interesuar se unë për atë stadium. Ne kemi bërë analizën e atij betoni disa herë dhe na ka dalë që është mirë. Brenda 1 muaji besoj që do të përfundoj puna në atë stadium.

Ramz Qeriqi, te rruga te hekurudha këtu në Lipjanna jemi duke vuajtur prej pluhurit e të cilën do ta vuajmë me vonë, është mirë që kompania me ujit që të mos bëhet pluhur se po shkaktohet pluhur në atë pjesë.

Argjend Tasholli, kam disa pyetje, e para ka të bëjë me Drejtoreshën e Kulturës pse nuk punon, Qendra Orientuese e Turizmit. Ju përgëzoj për shtegun e ecjes që e keni filluar në Gadime por kam një pyetje a do të bëhet rruga edhe ka lagja Limani apo vetëm ka pjesa në Gadime të Ulët.

Imri Ahmeti, rruga do te shkoj deri te familja Ahmet Limani, por edhe lartë atje bashkë me ndriçim dhe trotuar. Në javën e ardhshme do të fillojnë edhe çerdhja në Gadime dhe Sllovi. Qendra e turizmit për shkak të pandemisë është ndërpre, por unë kam pas takim me përfaqësuesit e Shqipërisë për turizmin jemi në bashkëpunim me Kryetarin e Vlorës për promovimin e turizmit në komunën tonë.

Argjed Tasholli, e pata fjalën hyrje a do të ketë edhe ka lagja Limani në Gadime.

Lumturije Bytyqi-Hasani, lumi në Sllovi është dëmtuar nga vërshimet shumë, a ka marr komuna ndonjë veprim për këtë qeshtje ,se në rast të vërshimeve do të shkaktonte papë probleme.

Albulena Kelmedni, shqetësimi i parë që pata me ngrit ke ai që e ngriti Bashkimi, për banorët e fshatrave Rubofc dhe Kojskë për dëmet që ju shkaktohen nga punimet në hekurudhë por e dha sqarimin kryetari. Çështja e dytë ka të bëjë me barnatoret të cilat kur e kanë orarin e kujdestarisë të dielave nuk po punojnë dhe sa do të kemi mundësi me ju bo presion që ato me respektuar orarin e kujdestarisë. Tjetra a ka naj strategji si do të bëhet zëvendësimi i mësimdhënësve të cilët po janë të infektuar me covid e ku po humbën orët mësimore.

Lulzim Rrustemi, procesi i vaksinimit në Lipjan a ka filluar, a është vaksinuar personeli shëndetësor, a ka kategori tjera të cilat janë vaksinuar. A ka rezerva dhe si po shkon puna e vaksinimit.

Merita Bytyqi, procesi i vaksinimit në Komunën tonë ka filluar ne e kemi zbatu planin në përpikëri jemi në fazën e parë të vaksinimit. Janë vaksinuar gjysma e stafit shëndetësorë kanë mbet edhe 80 vaksina. Janë vaksinuar pacientët me dializë me sëmundje të rënda kronike dhe shtëpia e të moshuarve. Po ashtu kemi filluar edhe me vaksinimin e personave të moshuar.

Imri Ahmeti, për lumin Sllovi kemi dërguar shkresë në ministri ende nuk na kanë kthyer përgjigje dhe nuk kam përgjigje. Sa i përket mos respektimit të orarit të barnatoreve jo me ju bo presion por me i denu. Dhe këtu nuk ka falje pavarësisht për kanë bëhet fjalë por inspektorati duhet me vepru. Sa i përket Arsimit kemi pas takim me ministreshën e arsimit, nuk na është lejuar me marr as staf rezervë por vetëm me vullnetarë. Presim zgjidhje por për momentin jemi në këtë gjendje. Sa i përket shtegut në Gadime nuk do të ketë hyrje nga pjesa lartë

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 41-te të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 41-të e Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 40 -të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II.

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2021

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit drejtor DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, kemi një shpenzim jashtëzakonisht të vogël të buxhetit. Sipas fondeve burimore kemi shpenzim jashtë zakonisht të vogël. Te buxheti i shpenzuar sipas grantit qeveritar ka gabime teknike të mëdha të cilat duhet të përmirësohen. Te të hyrat vetanake kemi shpenzime zero. Buxheti dhe shpenzimet nga donatorët edhe këtu e kemi zero. Po ashtu te shërbimet publike dhe planifikimi me urbanizëm edhe aty kemi shpenzim të vogël. Te shërbimet rezidenciale për cilin investim kapital bëhet fjalë. Te arsimi parafillor te granti qeveritar kemi shpenzim zero, po ashtu te arsimi fillor kemi shpenzim të vogël, ka edhe gabime teknike. Te arsimi i mesëm edhe këtu kemi shpenzime zero. Kam pyetje te shërbimet publike te shërbimet tjera kontraktuale për cilat bëhet fjalë. Një raport i buxhetit i punuar shkel e shko me shumë gabime teknike.

Albulena Kelmendi, një raport me shumë gabime teknike. Te shpenzimi i buxhetit në paga dhe mëditje figuron një shumë prej 12 mijë euro pse kjo shifër. Në këtë raport shqetësim mbetet te investimet kapitale ku pat projekte të cilat ende nuk kanë filluar. Po ashtu te mallrat dhe shërbimet te shkollat fillore kemi shumë jo mirë të shfrytëzuar.

Latif Ramadani, unë në fillim e përmenda që ka disa gabime teknike dhe gabimet ndodhin. Shpenzimet janë të ulëta por është fillimi i vitit dhe në fillim të vitin shpenzimet janë më të ultë derisa nuk fillojnë disa projekte. Te shpenzimet rezidenciale kemi punët që janë duke u kryer afër objektit.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën në vazhdim

III

Propozim vendim për aprovimin e rezervës komunale 2021-2023

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, e kam cekë edhe në KPF që ky propozim vendim nuk ka arsyetim dhe është dashtë me pas një arsyetim. Ne si grup i PDK-s në disa mbledhje më herët e patëm propozuar që të jetë një propozim për ndihmë të të prekurve me Covid-19. Këtë propozim nuk do ta votojmë pasi që jemi në kohë pandemie.

Hyra Bytyçi, ne si grup i LDK-s e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim dhe si të tillë do ta përkrahim.

Lulzim Rrustemi, një propozim vendim pa arsyetim. Kam një pyetje te hapësirat publike 60mij euro ku janë ato. Ne këtë propozim nuk do ta votojmë.

Latif Ramadani, kur shkon vendimi në ministri shkon pa arsyetim, e kemi hiç fasadimin e banesave pasi që atë projekt e kemi fituar me bankën botërore. Ministria e financave i ka goditë të gjitha komunat me këtë. Këto me herët i kemi pas të aprovuar në Kuvend.

Lumturije Bytyqi-Hasani, kemi një propozim vendim gjysmak pa arsyetim dhe deri me tani nuk kemi pas asnjë propozim vendim pa arsyetim. Është dashtë zyra ligjore me ja bo një arsyetim

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për 5 kundër aprovoi:

IV

Propozim vendim për lirimin nga pagesa e qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Vendimi

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, sa i përket këtij propozimi ne e përkrahim por jemi që të lirohen edhe të tjerët të dalim me një pako tjetër.

Daut Azemi, jemi duke e analizuar që të jetë në seancat e ardhme të kuvendit edhe një pikë tjetër për t'i liruar disa.

Majlinda Sylejmani, ne si grup i LDK-s e kemi shqyrto këtë propozim vendim dhe jemi qe të bëhet një analizë dhe të përfshihen edhe disa biznese të tjera të cilat kanë humbur gjatë pandemisë.

Ramiz Qeriqi, unë e përkrahi këtë propozim vendim, por kam një propozim qe të ju zvogëlohet pagesa e qerasë përfituesve të banesave sociale për shembull nga 20 euro në 10 euro.

Bekim Shabani, e kemi diskutuar edhe në KPF,këtë propozim vendim dhe ne jemi duke e analizuar me kryetarin që mbledhjet në vijim te dalim me një propozim tjetër.

Daut Azemi,neve nuk na është lejuar me ligj që të ju zbritet qiraja përfituesve të banesave sociale por do ta shohim mundësinë që edhe atyre të ju bëhet një zgjidhje. Jemi duke bërë analiza së bashku me kryetarin për këtë çështje.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për aprovoi:

Shtesë:Vendimi.

V

Propozim rregullore për taksat komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, ne si grup i PDK-s e kemi shqyrtuar dhe e përkrahim. Kam një pyetje a kanë filluar të zbatohet kjo rregullore, apo marrin leje në komunë kompanitë të cilat po i bllokojnë rrugët gjatë punimeve.

Ramiz Qeriqi, është mirë që po lirohen disa kategori por do të ishte mirë që në këtë të përfshihen edhe pensionerët

Daut Azemi, pensionerët janë të liruar me ligj.

Bekim Shabani,po ka filluar të zbatohet kjo rregullore në praktikë dhe ka disa raste të cilat kanë kërkuar leje nga drejtorati për shërbime publike

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi:

VI.

Propozim vendim për fillimin e procedurave për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" sh.a.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Vendimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, këtu e kemi një propozim vendim për krijimin e ndërmarrjes publike lokale, e ku qëllimi i themelimit të kësaj është rehatimi i shokëve dhe militantëve të partisë e jo interesin qytetarë. Kam një pyetje sa do t'i kushtoj buxhetit të komunës kjo. Çfarë të mira ju sjellë kjo ndërmarrje qytetarëve dhe çfarë të mira ju sjell kjo qytetarëve.

Daut Azemi, kjo është vetëm fillim i procedurave, ju i keni shfrytëzuar rrjetet sociale dhe mediat por keni gabuar. Kjo shoqëri aksionare, ndërmarrje veç do ta kursej buxhetin e komunës së Lipjanit dhe do të jetë me efikasë në kryerjen e punëve dhe shërbimeve. Ju shpesh keni kritikuar që po lidhin shumë kontrata, tash kur po don me u krijuar kjo prapë po kritikoni. Kjo është vetëm fillim i procedurave dhe kuvendi është ai që vendos.

Afrim Miftari, një propozim vendim të cilin e kemi analizuar po ashtu edhe ne KPF e kemi diskutuar dhe kemi konstatuar se me këtë vetëm janë iniciuar procedurat për krijimin e kësaj shoqërie aksionare. Konsiderojmë që qëllimi i themelimit të kësaj është i mirë, ku shumicën e këtyre veprimtarive komuna e kryen me kontrata me kompani të ndryshme. Me krijim e kësaj ndërmarrje komuna kursen në buxhet. Dhe nuk duhet me qenë skeptik pa filluar, dhe kjo është e mirë se hap vende të punës pavarësisht se kush punësohet. Dhe si të tillë ne e përkrahim.

Lulzim Rrustemi, përpara kemi një propozim për fillimin e procedurave për krijimin e ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana". E para nuk ka asnjë studim të fizibilitetit kur shihet çfarë game të madhe ka, e na kemi vetëm arsyetimin ligjor, por nuk ka arsyetim tjetër. Sa kushtojnë kontratat kornizë që janë lidhë për krejt qeto veprimtari, cili është çmimi, sa punëtorë do të punësohen, sa mjete financon komuna këtu ka procedurë. Kjo shkon në qeveri nëse i plotëson kriteret në qeveri e miraton qeveria. Me cilat kushte është e mirë kjo ndërmarrje, kur nuk është bërë fizibilitet as studim. Na nuk jemi për me themeluar këtë kompani. Dhe jemi kundër themelimit të kësaj ndërmarrje.

Ramiz Qeriqi, shumicën veç i thanë para folësit, është vështirë me kuptuar këtë kompani, pasi siç shihet këta komuna ska me themeluar vet kanë me lyp aksionar. Këtu kursehen mjete vetëm nëse komuna e formon vet, por prapë nuk ka mjete komuna me formu vet. Dhe kjo që të themelohet shkon kohë e gjatë, unë jam me përkrahë nëse e themelon vet komuna

Albulena Kelmendi, krijimi i kësaj ndërmarrje te na ka kriju konfuzitet edhe shumë thjeshtë duke u nisë nga fushë veprimtaria që e ka jashtë zakonisht të gjanë, sikur një super ndërmarrje që merret me të gjitha gjanat. Na jemi opozitë dhe jemi për të mirën e qytetarëve dhe nuk jemi kundër asnjë vendimi për të mirën e qytetarëve.

Daut Azemi, duhet me qenë opozitë konstruktive, Kjo është vetëm fillimi i proceduarve, e nuk dihet kush ka me u punësuar dhe nuk dihet a ka mu themeluar ose jo. Na jena tu folë për një shoqëri aksionare e cila ende nuk është themeluar.

Lumturije Bytyqi, tha se kërkoj që të respektohet rregullorja e punës së kuvendit dhe mos të përdoren shprehje jo adekuate.

Hyra Bytyçi, sa i përket propozimit për fillimin e procedurave për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" ne si grup mendojmë se është dashtë të fillohet shumë më herët me procedurat e themelimit, pasi që ka me marrë shumë kohë. Ndërmarrja që do të themelohet është shumë e mirë për qytetarët e komunës tonë. Ne si grup e përkrahim këtë propozim.

Bekim Shabani, propozim vendimi është vetëm inicim i procedurave për themelimin e kësaj ndërmarrje, së pari nxirret një vendim pastaj i bashkëngjitet një kërkesë në Ministri, pastaj ministria e përcjellë në këshill ministrorë, pastaj shkon në qeveri dhe qeveria e nxjerrë vendimin përfundimtar.

Lulzim Rrustemi, me qenë se është një vendim i jashtëzakonshëm duhet kohë për me analizuar, a keni argumente të mjaftueshme si do të mbrohet buxheti i komunës. Cila është arsyeja që po kërkon me themeluar këtë ndërmarrje. Në të kundërtën ne do të votojmë kundër.

Bekim Shabani, me themelimin e kësaj ndërmarrje punët do të kryhen shumë ma shpejtë shumë ma lehtë.

Megjithatë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 6 kundër dhe 2 abstenime aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shefqet Amërlahu, drejtor i DB-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

VIII

Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e kombit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiq drejtoreshë e DPU, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 17,³⁵

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi